

COVID-19 – Informacione për shëndetin dhe sigurinë në punë për vendet e punës

Kjo fletë informuese do t'ju ndihmon ta bëni vendin tuaj të punës të sigurt nga COVID-19. Gjithashtu në dispozicion keni informata tjera për COVID-19 në gjuhën tuaj ([COVID-19 Information in your language](#)).

Ligjet për shëndetin dhe sigurinë në punë kërkojnë që të kujdeseni për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e punëtorëve tuaj dhe të tjerëve në vendin e punës, përfshirë stafin tuaj, kontraktorët, klientët dhe vizitorët. Ju duhet të eliminoni apo minimizoni rreziqet ndaj shëndetit dhe sigurisë sa më shumë që është e mundur. Ky është ligji.

Plani dhe komunikimi

Ju duhet të menaxhoni riskun e ekspozimit ndaj COVID-19 në vendin tuaj të punës. Që t'i mbani punëtorët të sigurt ju duhet të keni një plan për vendin tuaj të punës që përfshin distancimin fizik, higjienën dhe pastrimin.

Për të qenë të sigurt se plani juaj është efektiv ju gjithashtu duhet që:

- Të jeni të përditësuar me informacionet e fundit nga burime të besueshme. Udhëzimet e shëndetit publik ([Public health directions](#)) në shtetin apo territorin tuaj përfshin rregulla për kufizimet për tipin tuaj të biznesit.
- Përgatituni se çfarë do të bëni nëse në vendin tuaj të punës do të kishte COVID.
- Konsideroni ndonjë rrezik të ri që mund të del nga ndryshimet e mënyrës së punës (psh. agresion nga klientët apo punëtorë të izoluar).
- Bisedoni me punëtorët tuaj dhe mendoni për shqetësimet e tyre.
- Trajtoni shtetin dhe sigurohuni që secili të din çfarë duhet bërë.
- Vendosni shenja dhe postere ([signs and posters](#)) për t'i kujtuar njerëzve rreziqet nga COVID-19 dhe se si të ndalin përhapjen.

Ndalni përhapjen e COVID-19

- Ju dhe punëtorët tuaj duhet të qëndroni në shtëpi nëse jeni i sëmurë (ethe, kollitje, fyt të pezmatuar dhe vështirësi në frymëmarrje).
- Sigurohuni që njerëzit të mbajnë 1.5 metra distancë fizike nga njëri tjetri.
- Inkurajoni punëtorët që shpesh të lajnë duart për së paku 20 sekonda me sapun dhe ujë ose të përdorin sanitizues të duarve me bazë alkooli.
- Inkurajoni punëtorët të praktikojnë higjienë të mirë dhe të kolliten apo teshtiten brenda krahut të tyre.
- Sigurohuni që vendi juaj i punës të pastrohet dhe dezinfektohet rregullisht. Pastroni shpesh sipërfaqet që preken më shumë.
- Furnizoni mjete mbrojtëse personale (siç janë dorezat dhe maskat) për punëtorët nëse ata kanë nevojë. Mësoni ata se si t'i përdorin ato.



Rishikim

- Rishikoni planin tuaj rregullisht për t'u siguruar se po funksionon dhe mbani të sigurt punëtorët nga COVID-19.
- Nëse paraqiten rreziqe të reja, konsideroni nëse ka nevojë të vendosni masa plotësuese.

Për më shumë informacione për COVID-19 dhe për shëndetin dhe sigurinë në punë, vizitoni uebfaqen e Australisë për sigurinë në punë ([Safe Work Australia ëbsite](#)).

Për më shumë fleta informuese për shëndetin dhe sigurinë në punë, vizitoni uebfaqen në gjuhën tuaj për informacione për COVID-19 ([COVID-19 Information in your language website](#)).

Për informacione të shëndetësisë, vizitoni [health.gov.au](#).

Për informacione specifike për vendin tuaj të punës ju lutem kontaktoni rregullatorin WHS në shtetin apo territorin tuaj ([WHS regulator in your state or territory](#)).